



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1750/3 Prot.

Tiranë, më 28.12.2017

VENDIM

Nr.244, datë28.12.2017

PËR

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT
TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 88, DATË 18.04.2017,
NË INSTITUCIONIN E BASHKISË TEPELENË**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 88, datë 18.04.2017, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin Nr. 20, datë 09.02.2017”, në Bashkinë Tepelenë,

KONSTATOVA SE:

Me Vendimin Nr. 20 datë 09.02.2017, “Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 79, datë 13.07.2016 dhe ligjshmërinë e veprimeve administrative të kryera nga Bashkia Tepelenë gjatë procesit të emërimeve, të kryera prej datës 27.04.2016 e në vazhdim”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vendosur verifikimin e akteve të emërimit, të cilat kanë dalë në kundërshtim me kërkesat e ligjit, duke mosrespektuar procedurat e rekrutimit në Bashkinë Tepelenë, prej datës 27.04.2016, e në vazhdim. Ky proces është përmbyllur me Vendimin Nr. 88, datë 18.04.2017, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin Nr. 20, datë 09.02.2017”, të Komisionerit, në të cilin është vendosur:

1. Të kërkoj nga Kryetari i Bashkisë Tepelenë të anulojë aktin administrativ nr.342 datë 01.11.2016 për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Drejtor në Drejtorinë Ligjore dhe Shërbimeve Organizative” në Bashkinë Tepelenë.
2. Pozicioni në fjalë duhet të plotësohet me anën e procedurave të konkurrimit të hapur, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i

ndryshuar, dhe akteve nënligjore dalë për zbatim të tij, apo nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë.

- 3. Njësia përgjegjëse gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit, duhet të përmbushë rregullat e përcaktuara në Kreun IV “Pranimi në shërbim civil”, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Vendimin Nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” dhe Vendimin nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, si dhe duke u bazuar në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike.*
- 4. Nga njësia përgjegjëse e Bashkisë Tepelenë duhet të fillojë zbatimin e vendimit brenda **30 ditëve** nga data e marrjes dijeni dhe pas këtij afati të dërgojë pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil një informacion të detajuar për zbatimin e këtij vendimi.*

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin Nr. 20, datë 09.02.2017, “Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr.79, datë 13.07.2016 dhe ligjshmërinë e veprimeve administrative të kryera nga Bashkia Tepelenë gjatë procesit të emërimeve, të kryera prej datës 27.04.2016 e në vazhdim”, me Vendimin Nr. 220, datë 31.10.2017, “Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 88, datë 18.04.2017, ‘Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin Nr. 20, datë 09.02.2017’”, ka vendosur fillimin e verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 88, datë 18.04.2017.

Për këtë qëllim u ngrit grupi i punës, me përbërje Migena Haznedari, Stela Ndoka dhe Joni Marko, Specialistë në Drejtorinë e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, të cilët në datën 09.11.2017, u paraqitën pranë institucionit të Bashkisë Tepelenë.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në institucionin e Bashkisë Tepelenë dhe subjekti u njoftua për fillimin e procesit me shkresën nr. 1750/2 prot., datë 31.10.2017, “Njoftim për fillimin e verifikimit”.

Grupi i punës, gjatë vizitës në subjekt komunikoi me njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe verifikoi materialet shkresore të cilat vërtetonin zbatimin e detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në vendimin paralajmërues. Takimi me njësinë e burimeve njerëzore, si dhe verifikimi i akteve dhe dokumentacionit shoqërues që administrohej nga kjo zyrë dhe zyra e Arkiv-Protokollit

është materializuar në procesverbalin e datës 09.11.2017, të mbajtur nga grupi i punës i Komisionerit dhe i nënshkruar nga personi i kontaktit të institucionit të Bashkisë Tepelenë, Përgjegjësja e Burimeve Njerëzore.

Pasi u administruan dhe u trajtuan materialet shkresore të vëna në dispozicion, rezultoi se:

Në pikën 1 të vendimit, Komisioneri i ka lënë detyrë Kryetarit të Bashkisë Tepelenë, që për rregullimin e ligjshmërisë në lidhje me emërimin në kundërshtim me ligjin të punonjësit ***** në pozicionin “*Drejtor në Drejtorinë Ligjore dhe Shërbimeve Organizative*” në Bashkinë Tepelenë, të anulojë aktin e emërimit Nr.342, datë 01.11.2016.

Më tej, **në pikat 2 dhe 3 të dispozitivit të vendimit** objekt verifikimi, Komisioneri ka kërkuar nga njësia përgjegjëse e kësaj bashkie që pozicionin “*Drejtor në Drejtorinë Ligjore dhe Shërbimeve Organizative*”, ta plotësojë nëpërmjet procedurave të konkurrimit të hapur, lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, duke mbajtur parasysh përcaktimet e Ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore dalë në bazë e për zbatim të tij.

Në zbatim të Ligjit Nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe Ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” për plotësimin e detyrës së lënë nga ana e Komisionerit ishin marrë këto masa:

Kryetari i Bashkisë Tepelenë, me anë të Urdhrit Nr.70/2, datë 08.05.2017, “*Për anulim të aktit administrativ nr. 342, datë 01.11.2016*”, ka bërë anulimin e këtij akti mbi emërimin e Lorenc Bamit në pozicionin “*Drejtor në Drejtorinë Ligjore dhe Shërbimeve Organizative*” në Bashkinë Tepelenë.

Me aktin Nr.42 prot., datë 27.03.2017, “*Njoftim për vende të lira pune*”, njësia përgjegjëse ka bërë shpalljen e procedurës së konkurrimit për pozicionin “*Drejtor në Drejtorinë Ligjore dhe Shërbimeve Organizative*” (apo “*Drejtor i Burimeve Njerëzore*” siç është quajtur nga njësia e burimeve njerëzore, e cila në të ardhmen duhet të bëjë kujdes që emërtesat e pozicioneve të punës t’i referojë saktë, siç janë të përcaktuara në strukturën dhe organikën e bashkisë), e cila ka qenë e hapur në të njëjtën kohë si për lëvizjen paralele ashtu edhe për ngritjen në detyrë.

Nga aktet e administruara rezulton se me Urdhrat nr. 39/1 dhe nr. 39/3, datë 17.03.2017, janë ngritur përkatësisht Komiteti i Pranimit për Lëvizjen Paralele dhe Komiteti i Pranimit për Ngritjen në Detyrë.

Në pikën 16, Kreu II, i Vendimit Nr. 242, datë 18.03.2015, “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*”, të Këshillit të Ministrave, parashikohet sa vijon:

“16. ... Komiteti i Pranimit për Lëvizjen Paralele (KPLP), ... ka në përbërje 3 (tre) anëtarë, si më poshtë vijon:

- a) 1 (një) përfaqësues nga institucioni, për të cilin është shpallur vendi vakant, i të njëjtit nivel ose i një niveli më të lartë se pozicioni që rekrutohet ...;*
- b) Eprorin direkt;*
- c) ... Në rastin e institucioneve të pavarura dhe njësive të qeverisjes vendore, anëtari i tretë emërohet nga titullari i institucionit, midis nëpunësve civilë të institucionit, të nivelit të mesëm drejtues, nëse është e mundur.”*

Nga këqyrja e Urdhrit nr. 39/1, datë 17.03.2017, rezultojnë në cilësinë e anëtarit të Komitetit të Pranimit për Lëvizjen Paralele, Nënkyetari i institucionit dhe dy ekspertë, çka bie ndesh me parashikimin e mësipërm. Një parregullsi e tillë vërehet edhe në Urdhrin nr. 39/3, datë 17.03.2017, me të cilin është ngritur Komiteti i Pranimit për Ngritjen në Detyrë. Nga përmbajtja e këtij akti rezulton se KPND përbëhet nga 4 anëtarë ndërkohë kur, në pikën 7, Kreu III, i Vendimit Nr. 242, datë 18.03.2015, “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*”, të Këshillit të Ministrave, parashikohet sa vijon:

“7. ... Komiteti i Pranimit për Ngritjen në Detyrë (KPND), ... ka në përbërje 5 (pesë) anëtarë, si më poshtë vijon:

- a) 1 (një) anëtar nga njësia përgjegjëse, i cili kryeson komitetin;*
- b) ... Për institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore, 1 (një) anëtar, i zgjedhur nga titullari, midis nëpunësve civilë të institucionit, nëse është e mundur, të nivelit të mesëm drejtues;*
- c) Eprorin direkt të pozicionit, për të cilin zhvillohet konkurrimi;*
- d) 2 (dy) ekspertë të fushës përkatëse, në varësi të fushës së vlerësimit.”*

Nga sa më sipër, rezulton se përbërja e KPND nuk është e plotë; nga 5 anëtarë që duhet të ketë, ajo përbëhet nga 4 anëtarë.

Për më tepër, në përbërjen e anëtarësisë së KPND njësia përgjegjëse ka gabuar kur ka caktuar në cilësinë e Kryetarit të Komitetit Përgjegjës e Sektorit Financiar në shkelje të germës a) të pikës 7, të Kreut III, të Vendimit Nr. 242, datë 18.03.2015. Sipas kësaj dispozite, Kryetar i këtij Komiteti duhet të jetë një anëtar i njësive përgjegjëse.

Referuar strukturës organizative të Bashkisë Tepelenë, miratuar me Vendimin nr. 20, datë 14.02.2017, Përgjegjësi i Sektorit Financiar është nën varësinë e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar. Nga ana tjetër, në këtë strukturë është parashikuar edhe Drejtoria Ligjore dhe Shërbimeve Mbështetëse, nën varësinë e së cilës ndodhet edhe sektori i burimeve njerëzore (nga komunikimi verbal me Drejtorinë e Drejtorisë Ligjore dhe Shërbimeve Mbështetëse, një veprim i tillë është kryer për shkak të mungesës së personelit të Bashkisë Tepelenë në përgjithësi dhe të burimeve njerëzore

*në veçanti; anëtari *****, i cili paraqitet në cilësinë e përfaqësuesit të Burimeve Njerëzore, është punonjës i këtij sektori pranë Bashkisë Memaliaj).*

Gjithashtu, nga këqyrja e akteve të sipërcituara rezulton se funksioni i Nënkryetarit të Bashkisë Tepelenë mbahet nga i njëjti person që kryen edhe detyrat e Përgjegjësit të Sektorit Financiar. Një gjë e tillë bie në kundërshtim me frymën dhe gërmen e Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, qëllimi i të cilit, ndër të tjera, është krijimi i një shërbimi civil të paanshëm politikisht (*neni I i ligjit*). Për më tepër, bazuar në nenin 47 të këtij ligji, nëpunësi civil mund të kryejë veprimtari të tjera, jashtë detyrës së tij në shërbimin civil, vetëm me lejen me shkrim të eprorit. Bazuar në nenin 8 të Ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në Administratën Publike”, kjo veprimtari nuk mund të dalë jashtë gamës së përcaktuar nga ligjvënësi, që do të thotë se nëpunësi civil mund të kryejë ekskluzivisht veprimtari sindikale, të përfaqësimit të punëmarrësve ose mësimdhënieje, kur ato nuk pengojnë në kryerjen e detyrës.

Nga komunikimi me Njësinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të institucionit, grupi i punës u vu në dijeni se për procedurën e lëvizjes paralele nuk është paraqitur asnjë kandidaturë. Për këtë arsye, procedura ka vijuar me ngritjen në detyrë. Në fazën e verifikimit paraprak ka rezultuar se plotëson kushtet dhe kërkesat e posaçme të përcaktuara në shpalljen për konkurrim nëpunësja J. Karteri. Sa më sipër rezulton nga njoftimi i printuar nga faqja zyrtare e internetit e Shërbimit Kombëtar të Punësimit (www.puna.gov.al).

Më tej, pas zhvillimit të procedurës së konkurrimit, është bërë publikimi i shpalljes së kandidatit fitues me më shumë se 70% të pikëve (*edhe ky njoftim është i printuar nga faqja e internetit e SHKP*).

Në përfundim të procedurës ka dalë akti nr. 83 prot., datë 28.05.2017, i Kryetarit të Bashkisë Tepelenë për emërimin në detyrën e Drejtorit në Drejtorinë Ligjore dhe Shërbimeve Organizative të nëpunëses *****, e cila gëzon Statusin e Nëpunësit civil me Vendimin nr. 13, datë 13.12.2014.

K o n k l u z i o n i

Për sa u parashtrua më sipër, pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin Nr. 88, datë 18.04.2017, “*Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin Nr. 20, datë 09.02.2017*”, të Komisionerit, rezulton se nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit Bashkia Tepelenë janë kryer një sërë parregullsish në procedurat e ndjekura për zbatimin e këtij vendimi, të cilat pjesërisht kanë ardhur për shkak të kuptimit të gabuar të ligjit dhe pjesërisht për shkaqe objektive, të tilla si mungesa e personelit të nevojshëm të Bashkisë. Për këto arsye, Vendimi Nr. 88, datë 18.04.2017, do të konsiderohet i zbatuar nga ana e Njësisë së Burimeve Njerëzore, duke i tërhequr vëmendjen kësaj të fundit që në të ardhmen të bëjë kujdes që të zbatohet me përpikmëri ligjin dhe rekomandimet e Komisionerit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 88, datë 18.04.2017, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin Nr. 20, datë 09.02.2017”, në Bashkinë Tepelenë.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse të institucionit të Bashkisë Tepelenë, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit Nr. 88, datë 18.04.2017.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Bashkisë Tepelenë dhe të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha